



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Legjislatura e III-të

Nr. 21/09

Prishtinë, më 29.04.2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Hafize Hajdini, Kosara Nikolić, Müfera Şinik, Enis Kervan, Hetem Arifi, Zafir Berisha, Sadik Idriz, Mursejl Haljilji, Numan Balić, Xhevdet Neziraj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Zylfi Merxha.**

Gjithashtu të pranishëm ishin: Esat Brajshori kryetar i Komisionit për Shërbime Publike dhe Administratë Lokale, monitruar nga KDI, OSCE, ICO.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante) dhe Gazmend Avdyli (praktikant).

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 7.4.2009;
3. Diskutim lidhur me amendamentin e komisionit për Projektligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës;
4. Diskutim lidhur me implementimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve  
Të ftuar: Kryetari i Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, z. Esat Brajshori,  
Kryetari i komisionit për punë të Brendshme dhe Siguri, z. Rrustem Mustafa;
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi**, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 7.04.2009**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 7.4.2009 , u miratua pa vërejtje

### **3. Diskutimi lidhur me amendamentin e komisionit për projektligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës**

**Kryesuesi**, theksoi se në seancën plenare të dt. 16.04.2009 me rastin e votimit të amendamenteve të për Projektligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës, nuk është vënë në votim amendamenti i propozuar nga komisioni për komunitete. Me këtë rast nuk i është dhënë fjala kryetar i komisionit edhe pse e kam kërkuar. Kjo tregon shkelje të Rregullores së punës së Kuvendit. Prandaj kërkoi që komisioni të vazhdoj procedurën për të hartuar një shkresë ndaj organeve përgjegjëse, për mospërfilljen e komisionit dhe mosrespektimin e procedurave.

**Sanije Aliu**, lidhur me amendamentin e propozuar, theksoi se komisioni nuk ka qenë këmbëngulës, në veçanti nuk është vërejtur këmbëngulësia e kryetarit të komisionit. Sipas saj nuk ka nevojë për një reagim të kësaj çështje për shkak të mundësisë së prishjes së imazhit që mund të krijohet për këtë komision. Do të duhej që të jemi të bashkuar dhe të mbrojmë qëndrimet tona të arritura me konsensus si komision, për propozimet apo rekomandimet tona që i bëjmë.

**Kryesuesi**, duke u ndërlidhur theksoi se ka kërkuar fjalën por nuk i është dhënë. Insistoj që të bëhet një shkresë procedurale në mënyre që në rastet tjera të respektohen funksionet që ka ky komision.

**Numan Balic**, theksoi se kryesuesi i seancës ka shkelur Rregulloren e punës së Kuvendit, si rezultat i asaj që nuk e ka hedhur në votim amendamentin e komisionit. U pajtua me mendimet se duhet të jemi të bashku si komision në mbrojtjen e qëndrimeve tona.

**Enis Kervan**, duke u ndërlidhur me temën, theksoi se nuk po respektohet autoriteti që ka ky komision dhe kjo tregon se ne po shërbejmë vetëm si dekor. Prandaj duhet të bashkuar të insistojmë që të respektohet autoriteti dhe kompetencat që janë të garantuar me rregullore për këtë komision.

**Sadi Idriz**, gjithashtu shprehu pakënaqësinë për mospërfilljen e këtij komisioni. Një situatë e tillë po ndodh edhe për shkak të miratimit me procedurë të shpejtë të Ligjeve të pakos së Ahtisarit, për çka edhe po shkaktohen probleme për minoritete në përfaqësimin e tyre në borde dhe këshilla të ndryshme të niveleve shtetërore dhe ndërmarrjet publike.

**Sanije Aliu**, theksoi se për problemet e komuniteteve duhet diskutuar në komision dhe jo jashtë parlamentit. Kjo nënkupton se duhet të jemi unik për qëndrimet tona të arritura në komision. Prandaj për shkak të një situatë të moskordinimi të komisionit mos të krijohet përshtypje se nuk po respektohen të drejtat e komuniteteve.

**Kryesuesi**, ne do të veprojmë konform procedurave dhe rregullave ligjore. Do të ngrisim zërin në ato çështje që ekziston konsenzusi në komision. Kërkoi që të vazhdohet procedura lidhur me vërejtje tona për mosrespektimin e kompetencave të komisionit në të drejtën e tij për të propozuar amendamente dhe për të qenë objekt votimi në seancë.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se tetë vota Për, dy Abstenime dhe asnjë Kundër, Komisioni nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Vazhdohet procedura e përgatitjes së një shkrese si reagim për mosrespektimin e kompetencave të komisionit të parapara me Rregulloren e punës së Kuvendi në të drejtën e tij për propozimin e amendamenteve dhe votimit të tyre në seancë në cilësinë e komisionit kryesorë.

### 4. Diskutim lidhur me implementimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve

**Sanije Aliu**, për njoftim theksoi se Kuvendi ka miratuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve, por se në këtë drejtim kemi vërejtje nga komuniteti Turk se ky Ligj nuk po zbatohet në komunat ku jetojnë ata, përkatësisht dokumentet civile nuk po shtypen në gjuhë e tyre. Për këtë gjë më shkrim është kërkuar të jepen sqarime nga Ministri i Punëve të Brendshme, përgjigja e së cilit ka qenë se për shkaqe financiare për momentin nuk po mund të shtypen këto dokumentet civile në gjuhën turke.

**Müfera Shinik**, duke u ndërlidhur, theksoi se në Komunën e Prizrenit dhe Mamushes nuk po shtypen dokumentet civile në gjuhën turke (të tilla si letërnjoftimet, certifikatat e lindjes), të cilat më parë janë shtypur. Gjithashtu edhe shenjat dhe tabelat nuk janë në gjuhën turke. Kjo tregon se nuk po zbatohet Ligji për gjuhët, për të cilën gjë edhe ka njoftuar Këshillin Konsultativ për Komunitete.

**Esat Brajshori**, theksoi komisioni në kuadër të aktiviteteve ka monitoruar Ligji për gjuhët, për të cilin ka realizuar vizitë në komunën e Prizrenit, dhe në disa komuna tjera. Në takimet që kanë pasur me zyrtarët komunal është kuptuar se nuk ka pengesa në zbatimin e ligjit. Këto vizita janë realizuar para fillit të shtypjes së dokumenteve civile nga institucionet e Republikës së Kosovës.

**Numan Balic**, theksoi se jo vetëm në komunën e Prizrenit por edhe në komunat tjera nuk po zbatohet ky ligj. Dokumentet civile nuk po lëshohen në gjuhën e komuniteteve, të cilat ky ligj i garanton si gjuhë zyrtare në ato vende. Një situatë e tillë e shkeljes së ligjit, ekziston edhe në institucionet tjera shtetërore (rasti i shëndetësisë ku shkresat dhe informacionet nuk lëshohen dhe jepen gjuhën e personit që flet).

**Enis Kervan**, përmendi disa vendime të Kuvendit komunal të Prizrenit, Gjilanit, Prishtinës, Vushtrisë, me të cilat është garantuar gjuha turke si gjuhë zyrtare në ato komuna, dhe e njëjta nuk po zbatohet. Asnjë dokument nuk lëshohet në këtë gjuhë. Kjo gjendja e krijuar po shkakton pakënaqësi te komuniteti turk dhe boshnjak që jetojnë në këto lokalitete, të cilët po bojkotojnë pagesën e tatimit në pronë. Falënderoj mbështetësit për zgjidhjen e këtij problemi dhe kërkoj që së bashku ti tejkalojnë ato, në mënyrë që ligji të zbatohet.

**Esat Brajshori**, lidhur me gjendjen e krijuar në moszbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve pas zgjidhjes së statusit, theksoi se komisioni pret ankesa nga komunat apo personat përkatës për të shqyrtuar ato. Për të diskutuar për problemet e qeverisjes lokale, komisioni ka ftuar edhe Ministrin e Pushtetit Lokal, takimi mes së cilit ka dështuar për shkaqe objektive. Përndryshe përgëzoi parafolësin që dokumentoi vendimit për aplikimin e gjuhës dhe kjo do të shërbej si shtytje që komisioni të siguroj informacione dhe të jap rekomandime lidhur me ligjin në fjalë.

**Xhevdet Neziraj**, theksoi se komisioni ka rënë në nivel të detyrës. Shumë detyra që kërkohet nga komisionet tjera për monitorimin e ligjeve, mund ti bëjë vet ky komision. Komisioni të shkoj në vend ngjarjes dhe të shoh se a po respektohet ligji. Psh., të monitorojmë për të drejtat e komuniteteve, dhe

të shohim se sa po zbatohet ai në raport me punësimin e komuniteteve në ndërmarrjet publike, në dogana dhe në institucione tjera publike dhe shtetërore. Në këtë drejtim mund të organizojmë edhe dëgjim publik.

**Zafir Berisha**, propozoi që komision të nxjerr një përfundim apo rekomandim me të cilën kërkohet zbatimi i Ligjit për gjuhët dhe Ligjit për mbrojtjen e komuniteteve. Çështja për letërnjoftimet duhet diskutua me ministrat përkatës për të kërkuar zgjidhjen e problemit dhe respektimin e Ligjit.

**Sanije Aliaj**, në lidhje me Ligjin për gjuhët, propozoi të vizitohet komuna e Prizrenit, të ftohen Ministri i pushtetit lokal dhe Ministri i punëve të brendshme në komision, dhe më pas të nxjerrën rekomandimet e komisionit për të gjeturat eventuale, drejtuar institucioneve relevante për të kërkuar zbatimin e ligjit.

**Numan Balic**, mbështeti propozimin për vizitë komunave, si dhe takim me ministrat. Kërkoj gjithashtu hartohet raporti dhe të debatohet në Kuvend për këto çështje.

**Sadik Idriz**, përkrahu propozimet e Znj. Aliaj. Theksoi se ky komision është shumë pasiv në përmbushjen e detyrave. Kjo tregon edhe mosqedrimi i kryetarit deri në fund të mbledhjes. Problemet në moszbatimin e ligjit duhet të jetë një shkas që ky komision duhet të monitoroj ligjin dhe më pas të hartoj një raport për Kuvendin.

**Kosara Nikolic**, theksoi se nga kjo që u bisedua do të duhej që si komisioni të nxjerr përfundimet. Të realizohen vizitat në teren për të parë zbatimin e ligjit, të ftohen ministrat në mbledhjen e komisionit dhe më pas të jepen rekomandimet për të gjeturat. Në këtë drejtim kemi nevojë edhe për bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare. Mungesa e kryetarit të komisionit ndodh edhe me komisionet tjera.

**Sanije Aliaj**, theksoi se duhet bërë përpjekje paraprakisht të zgjidhen problemet vet, dhe në këtë drejtim nuk përjashtohet ndihma ndërkombëtare.

**Mufera Shinik** propozim së pari te ftohen ministrat e pastaj te dalim ne teren.

**Enis Kervan** problemet me përdorimin e gjuhëve egzistojnë edhe në komunat tjera dhe jo vetëm në Prizren. Propozoi që të vizitohen komunat pastaj të ftohen ministrat. Më pas të hartohen rekomandimet drejtuar institucioneve përkatëse lidhur me problemet dhe të gjeturat në implementimin e Ligjit.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Zëvendëskryesuesesja konstatoi se, Komisioni njëzëri nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Të zbatohet Ligji për përdorimin e gjuhëve.
- II. Të vizitohet komuna e Prizrenit për të marr informacione lidhur me problemet në zbatimin Ligjit për gjuhët, në të cilin takim duhet të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e komuniteteve në nivelin lokal.
- III. Të ftohen ministrat përkatës në mbledhjen e komisionit për të dhënë sqarime dhe llogari rreth zbatimit të ligjit.

Mbledhja përfundoi në ora 13:25

Përgatitur nga

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

**Bojan STOJANOVIĆ**